LIGJ
Nr.9761, datë 25.6.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE "TERGESTEA" SRL TRIESTE (ITALI) PËR RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PRAPAMBETURA"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe "Tergestea" Srl Trieste (Itali) për riskedulimin e borxheve të prapambetura".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5385, datë 2.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TERGESTEA SRL TRIESTE (ITALI) NË LIDHJE ME RISKEDULIMIN E BORXHEVE TË PAPAGUARA

Marrëveshje e datës __/__/2007, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu i quajtur "Këshilli", i përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Negociimin e Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë (këtu i quajtur (GCNEDA) dhe "Tergestea" Srl Trieste, i përfaqësuar nga Z.Guido Valenzin.

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve të paguara, që rrjedhin nga transaksionet tregtare, ndërmjet "Tergestea" Srl dhe ish-ndërmarrjeve shqiptare shtetërore të tregtisë me jashtë.

Këshilli dhe Tergestea Srl bien dakord që:

shuma e borxheve të ish-ndërmarrjeve shqiptare shtetërore të tregtisë me jashtë ndaj "Tergestea" Srl arrin në 292.168.333,00 ITL.

Shuma e borxhit të "Tergestea" Srl ndaj parkut të mallrave të eksportit Durrës arrin në 38.315,00 Usd.

Neni 2

Shuma prej 292.168.333,00 ITL duhet të konvertohet në euro me një kurs të caktuar nga Këshilli i Bashkimit Europian më 31 dhjetor 1998. Kështu, borxhi ndaj "Tergestea" Srl duhet të jetë 150.892,40 euro.

Shuma prej 38.315,00 USD duhet të konvertohet në euro me një kurs EURO/USD të datës 20

shkurt 2007. Kështu borxhi ndaj palës shqiptare duhet të jetë 29.128,00 EURO.

Neni 3

Këshilli dhe "Tergestea" Srl bien dakord që shuma totale e borxheve të Këshillit ndaj "Tergestea" Srl duhet të jetë 121.764.40 euro.

Neni 4

Këshilli do te shlyejë borxhin ndaj "Tergestea" Srl në shumë prej 121.764, 40 euro në një këst që bëhet i pagueshëm më 30 qershor 2007.

Neni 5

Këshilli i paguan "Tergestea" Srl interes për shumën e borxhit në pajtim me nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, në nivelin LIBOR me bazë 6-mujore, në vit, për periudhën që fillon më 31 gusht 2006 deri në datën që është e kërkueshme pagesa e shumës principale.

Neni 6

"Tergestea" Srl heq dorë nga kërkesa për interesat e vjetra për periudhën nga data e maturimit të pretendimeve deri më 31 gusht 2006.

Neni 7

Në rastin e vonesës në shlyerjen e kërkueshme në bazë të nenit 3, norma e interesit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj Marrëvejeje rritet me pikë një për qind, nga data që bëhet e kërkueshme shlyerjea e këstit deri në datën në të cilën merret pagesa.

Neni 8

Çdo pagesë në favor të "Tergestea" Srl realizohet në llogarinë përkatëse që njoftohet nga "Tergestea" Srl.

Neni 9

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.

Neni 10

Njoftimet bëhen në pajtim me këtë Marrëveshje dhe në adresat e mëposhtme:

Këshilli:
Ministra e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri

Tel: +3554228405
Fax: +3554229200

"Tergestea" Srl:
Via Del Canal Piccolo, 2 – 34121 Trieste

Tel: +39 040 7777221
Fax: +39 040 365262

Neni 11

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore të kërkuara

nga legjislacioni shqiptar dhe është e vlefshme dhe detyruese për Palët deri se ato të përmbushin detyrimet parashikuara prej saj.

Bërë në Tiranë, më……..2007, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.